



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E LISTAVE EMËRORE TË SHTETASVE TË CILËT MUND TË EMËROHEN KRYESISHT ANËTARË TË KQV-VE PËR ZGJEDHJET PËR NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 28.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për miratim të listave emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", nenin 37, nenin 38, i ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe propozimet e depozituara,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", ka publikuar në gazeta dhe faqen e internetit njoftimin për shprehje interesi nga shtetas që janë të gatshëm të ushtrojnë detyrën e anëtarit të KQV-së për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

KQZ, përmes njoftimit publik informoi për:

- kriteret që duhej të plotësonin shtetasit për emërim kryesisht anëtarë të KQV, në respektim të përcaktimeve të nenit 37 dhe 38 të Kodit Zgjedhor;
- afatin kohor të aplikimit dhe dokumentacionin që duhej të paraqitej;



Nr. 920 i Vendimit Data 28.06.2019 e Vendimit Ora 14:30 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

- procedurat e përzgjedhjes për emërim kryesisht anëtar i KQV;
- të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të KQV të emëruar kryesisht;
- masën e shpërblimit;

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Has, kanë shprehur interes 16 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Kavajë, kanë shprehur interes 5 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Durrës, kanë shprehur interes 3 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Nga verifikimi i DPB dhe nga shyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se shtetasit përmbushin kushtet ligjore për tu emëruar kryesisht në detyrën e anëtarit të KQV-së, si dhe nuk janë në kushtet e papajtueshmërisë për ushtrimin e kësaj detyre:

- janë zgjedhës;
- kryesisht janë me arsim të mesëm;
- janë me vendbanim në zona zgjedhore përkatëse (Bashkitë përkatëse);
- janë të padënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- nuk janë marrë masa disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme;

Në përmbushje të përcaktimeve të nenit 3, pika 3, të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", paraqiten për miratim të KQZ lista emërore e shtetasve të tre zonave zgjedhore, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 37, dhe 38, të Kodit Zgjedhor, dhe mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve nga KZAZ-të nr.10 nr.42, nr.23, nr.24 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, nenin 37, nenin 38, i ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.10, Bashkia Has, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur.



Nr. 920 i Vendimit Data 28.06.2019 e Vendimit Ora 14:30 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

2. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.42, Bashkia Kavajë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 2 bashkëlidhur.
3. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.23, nr.24, Bashkia Durrës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 3 bashkëlidhur.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 920 i Vendimit Data 28.06.2019 e Vendimit Ora 14:30 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019